REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

# Kodi i lëndës: INF 110
# Lënda: Terminologji Mjekësore

| PROGRAMI I LËNDËS<br>**Terminologji Mjekësore** | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Titullari i lëndës:** | **Yllka Bilushi** *Prof. Dr, Phd në Shëndet Publik* ____________________ | | | | | | | | |
| **Ngarkesa:** | Kredite | Orë mësimi në auditor | | | | | | Studim individual | Totali |
| | | Leksion | Seminar | Labs | Praktikë | Projekte | Total | | |
| | 4 ECTS | 30 | 15 | 0 | 0 | 0 | 45 | 55 | 100 |
| **Tipologjia e lëndës** | Lëndë ndërdisiplinore / integruese | | | | | | | | |
| **Vitiakademik /Semestri kur zhvillohet lënda** | Viti I, Semestri I | | | | | | | | |
| **Lloji i lëndës** | E detytueshme | | | | | | | | |
| **Programi i studimit** | Bachelor në "Infermieri të Përgjithshme" | | | | | | | | |
| **Kodi i lëndës** | INF 110 | | | | | | | | |
| **Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës** | yllka.bilushi@univlora.ed.al | | | | | | | | |

| PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT | |
|---|---|
| **Përmbledhja** | Terminologjia mjekësore është një lëndë në të cilën studentët marrin njohuri mbi termat më të përdorshme latine dhe greke, fjalëformimi në këto gjuhë, morfologji, formim i recetës si dhe përdorimi i tyre klinik. Të kuptojnë e të përdorin shprehje të jetës së përditshme si dhe të jenë të aftë të përkthejnë materiale të shkencës mjekësore.Në këtë modul futen dhe seminaret të cilat synojnë të diskutojnë dhe kontrollojnë njohuritë që studentët marrin gjatë leksioneve. |
| **Objektivat e lëndës** | Në përfundim të këtij kursi studentët do të kenë njohuri në drejtim të<br>▪ Njohjes me teminologjinë mjekësore, latine dhe greke.<br>▪ Njohjes me pjesët e ligjëratës në gjuhën latine.<br>▪ Njohjes me fjalë të fjalorit anatomik dhe shëndetësor.<br>▪ Njohjes me recetën mjekësore dhe rëndësinë e saj. |
| **Rezultatet e të nxënit** | Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:<br>▪ Të kuptojnë e të përdorin shprehje të jetës së përditshme.<br>▪ Të jenë të aftë të përkthejnë materiale të shkencës mjekësore<br>▪ Të kuptojnë e të përdorin fjalorin e terminologjisë mjekësore në gjuhën latine. |

## KONCEPTET THEMELORE

1. Pozicionet anatomike, planet dhe drejtimet.
2. Morfologjia. Emri, Rasat.Lakimi i emrit.
3. Folja (zgjedhimi, mënyra, trajta). Zgjedhimi i foljes latine.
4. Parashtesatdheprapashtesat në gjuhën latine.
5. Terminologji mjekësore, fjalët e përbëra.
6. Organet dhe Sistemet.
7. Përmbajtja e recetës, modeli i një recete të përbërë.

8. Format më kryesore të barnave. Njohuritë themelore.

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| I. | **Tema 1 -** Gjuha Latine dhe Mjekësia. Fonetika (*Alfabeti Latin*). Klasifikimi i tingujve. *Terminologjia shkencore mjekësore në formimin e vet gjithmonë sinkronizohet me zhvillimin e vetë mjekësisë.*<br>**Tema 2 -** Shqiptimi i zanoreve, bashkëtingëlloreve.Bashkime tingujsh me bashkëtingëlloren H. Pozicionet anatomike, planet dhe drejtimet. *Tingujt e gjuhës latine, si në çdo gjuhë, ndahen në dy grupe të mëdha: në zanore dhe në bashkëtingëllore. Në anatomi ka disa pozicione të quajtura "anatomike"të trupit.*<br><br>**Seminar 1 -** Alfabeti latin. Shqiptimi i shkronjave. Klasifikimii tingujve. Shkrimi dhe shqiptimi i saktë i fjalëve me zanore dhe bashkëtingëllore. Përvetësimi i pozicioneve anatomike, planeve dhe drejtimeve. | *fq. 13-18*<br><br>*fq. 18-28* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Seminar 1 orë* |
| II. | **Tema 3 -**Terminologji mjekësore. Bashkëtingëllore të dyfishta. *Hasen në fjalët me origjinë greke dhe jo greke.*<br>**Tema 4 -** Diftongjet (Dyzanoret). Shqiptimi i diftongjeve. Terminologji mjekësore.Ndarja e fjalëve në rrokje. Rregullat e theksimit. *Kur dy zanore bashkohen dhe shqiptohen si një tingull, atëherë kemi një diftong (dyzanor). Fjala ndahet në aq pjesë sa zanore ose diftongje ka.*<br><br>**Seminar 2 -** Shqiptimi dhe shkrimi i saktë i bashkëtingëlloreve të dyfishta. Leximi dhe shqiptimi i drejtë i fjalëve me diftongje. Ndarja e fjalëve në rrokje. Rregullat e theksimit të fjalëve latine. | *fq. 31-34*<br><br>*fq. 35-39* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Seminar 1 orë* |
| III. | **Tema 5 -** Morfologjia. Emri, Rasat.Lakimi i emrit.Lakimi i parë. *Gjuha latine ka dhjetë pjesë të ligjëratës.*<br>**Tema 6 -**Fjalët me origjinë latine *dhe ato* me origjinë greke. Terminologji mjeksore.*Fjalët bazë më të përdorshme në terminologjinë latine.*<br><br>**Seminar 3 -** Pjesët e ligjeratës. Rasat në gjuhën latine. Shembuj të lakimit të emrave. Lakimi i parë i emrave, shembuj. Terminologji mjekësore. | *fq. 40-45*<br><br>*fq. 46-54* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Seminar 1 orë* |
| IV. | **Tema 7 -**Lakimi i parë. *Emrat e lakimit të parë janë kryesisht të gjinisë femërore.*<br>**Tema 8 -** Folja (zgjedhimi, mënyra, trajta). *Njohuri të përgjithshme rreth foljes nëgjuhën shqipe.*Zgjedhimi i foljes latine (zgjedhimi i I, II, III, IV). *Zgjedhimet latine dallohen midis tyre nga mbaresa e pskajores së kohës së tashme.*<br><br>**Seminar 4-** Lakimi i fjalëve që bëjnë pjesë në lakimin e parë. Katër zgjedhimet e foljeve.Përcaktimi i temës së kohës së tashme. | *fq. 54-55*<br><br>*fq. 55-56* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Seminar 1 orë* |
| V. | **Tema 9 -** Parashtesatnë gjuhën latine. *Për të formuar fjalë më shpesh përdoren parashtesat, të cilat mund të përmbajnë një ose më shumë rrokje( zakonisht parafjalë ose ndajfolje).*<br>**Tema 10 -** Lakimi i dytë. Shembuj Lakimi mbiemrash të lakimit I dheII. Përshtatja e mbiemrit me emrin. *Në lakimin e dytë bëjnë pjesë emrat dhe mbiemrat e gjinisë mashkullore që në rasën emërore dalin me mbaresat us,er dhe ata të gjinisë asnjëanëse që në emërore dalin me um. Mbiemri në gjuhën latine, ashtu si edhe në gjuhën shqipe, përshtatet me emrin me të cilin lidhet në rasë, në numër dhe në gjini.*<br><br>**Seminar 5 -** Lakimi i fjalëve që bëjnë pjesë në lakimin e parë. Katër zgjedhimet e foljeve.Përcaktimi i temës së kohës së tashme. | *fq. 57-61*<br><br>*fq. 62-72* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Seminar 1 orë* |

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| **VI.** | **Tema 11 -** Prapashtesat. Terminologji mjekësore.<br>*Prapashtesa është një shkronjë e vetme ose një rrokje e cila vendoset në fund të fjalisë për të ndryshuar kuptimin e saj.*<br>**Tema 12 -** Folja (mbaresat vetore të foljes, trajta pësore). Koha e tashme e mënyrës dëftore të trajtës pësore (zgjedhimi I, II, III, IV).*Mbaresatvetore të foljes (trajta pësore).*<br><br>**Seminar 6 -** Prapashtesat më të zakonshme. Koha e tashme e mënyrës dëftore të trajtës pësore. | *fq. 69-72*<br><br><br>*fq. 73-76* | Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Seminar 1 orë* |
| **VII.** | **Tema 13 -** Terminologji mjekësore.Fjalët e përbëra.<br>*Fjalët e përbëra në terminologjinë mjekësore.*<br>**Tema 14 -** Lakimi i tretë. Tipi i parë i lakimit të tretë (me karakter bashkëtingëllor). Emrat e gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjëanëse të lakimit të tretë. Tipi i dytë i lakimit të tretë (tipi i përzier dhe tipi me zanore).<br>*Në lakimin e tretë hyjnë emrat e të tre gjinive që në rasën gjinore njëjës dalin me mbaresën -is.*<br><br>**Seminar 7 -** Fjalët e përbëra më të zakonshme në terminologjinë mjekësore. Shembuj të tipit të parë të lakimit të tretë, si dhe të tipit të dytë të lakimit të tretë. | *fq. 77-85*<br><br>*fq. 86-104* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br><br><br>*Seminar 1 orë* |
| **VIII.** | **Tema 15 -** Mbiemrat e lakimit të tretë.<br>*Mbiemrat e lakimit të tretë, në bazë të mbaresave të rasës emërore të numrit njëjës, ndahen në tre grupe.*<br>**Tema 16 -**Pjesorja e kohës së tashme veprore. Mënyra lidhore, mbaresat vetore të mënyrës lidhore, formimi i kohës së tashme.<br>*Pjesorja e kohës së tashme veprore formohet duke i shtuar temës së kohës së tashme mbaresat përkatëse për të katër zgjedhimet.*<br><br>**Seminar 8 -** Lakimi i mbiemrave me tre mbaresa, me dy mbaresa dhe me një mbaresë. Pjesoretë kohës së tashme veprore që përdoren në terminologjinë mjekësore. | *fq. 109-115*<br><br><br>*fq. 116-123* | Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br><br>*Seminar 1 orë* |
| **IX.** | **Tema 17 -** Terminologji mjekësore, fjalët e përbëra.<br>*Ndajfolje që shfaqen si pjesë e parë e emrit të përbërë.*<br>**Tema 18 -** Lakimi i Katërt. Lakim emrash të lakimit të katërt bashkë me mbiemra. *Lakimi i katërt përfshin emra të të tre gjinive që në rasën gjinore njëjes dalin me mbaresën us.*<br><br>**Seminar 9 -** Emra që shfaqen si pjesë e dytë e emrit të përbërë. Shembuj lakimi të lakimit të katërt. | *fq. 124-128*<br><br>*fq.129-135* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Seminar 1 orë* |
| **X.** | **Tema 19** – Lakimi i Pestë. Lakim emrash të lakimit të pestë me mbiemra. Tabela përmbledhëse e mbaresave të emrave latinë në rasën emërore njëjës dhe në rasën gjinore të të pesë lakimeve.<br>*Mbaresat rasore të lakimit të pestë.*<br>**Tema 20 -** Shkallët e krahasimit të mbiemrave.<br>*Shkallët e krahasimit tëmbiemrave.*<br><br>**Seminar 10 -** Lakim emrash të lakimit të pestë. Formimi i shkallëve krahasore të mbiemrave. | *fq. 136-140*<br><br><br><br>*fq.141-145* | Leksion 1 orë<br><br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>*Seminar 1 orë* |

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| XI. | **Tema 21** – Veçori në formimin e shkallëve të mbiemrave. Numërorët. *Mbiemra me mbaresa të ndryshme formojnë shkallë të ndryshme të krahasimit.*<br>**Tema 22** – Ndajfoljet. Terminologji mjekësore. Shkallët e krahasimit tëndajfoljeve.*Ndajfoljet nga pikëpamja e formimit të tyre janë dy llojesh.*<br><br>**Seminar 11 -** Formimi i shkallës sipërore të mbiemrave që janë me mbaresa të ndryshme. Numërorët themelorë dhe rreshtorë. Formimii ndajfoljeve prej mbiemrave. | *fq. 145-157*<br><br>*fq.158-170* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Seminar 1 orë* |
| XII. | **Tema 23 -** Përemrat vetorë, pronorë, dëftorë, lidhorë, pyetës, të pakufijshëm dhe korrelativë. Përdorimi i përemrave në recepturë.*Rëndësia e përdorimit të tyre.*<br>**Tema 24 -** Organet dhe Sistemet. Sistemi i Frymëmarrjes *dhe* Kardiovaskular *Organet dhe sistemet janë të lidhura midis tyre dhe funksionet e tyre plotësisht mund të kryhen vetëm në varësi nga puna e organeve dhe sistemeve të tjera.*<br><br>**Seminar 12 -** Funksionet dhe terminologjia mjekësore e sistemeve. | *fq. 172-177*<br><br>*fq.178-182* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Seminar 1 orë* |
| XIII. | **Tema 25** – Sistemi Nervor *dhe* Urinar. Sistemi riprodhues femëror dhe mashkullor. *Funksioni i sistemeve dhe terminologjia latine përkatëse.*<br>**Tema 26 -**Sistemi Endokrin *dhe* Muskulo-skeletor. *Funksioni i sistemeve dhe terminologjia latine përkatëse*<br><br>**Seminar 13 -** Funksionet dhe terminologjia mjekësore e sistemeve. | *fq. 183-186*<br><br>*fq.187-188* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Seminar 1 orë* |
| XIV. | **Tema 27 -** Sistemi i Organeve të Tretjes, Limfatik. Terminologji mjekësore. *Funksioni i sistemeve dhe terminologjia latine përkatëse.*<br>**Tema 28 -** Receta. Paraqitja e jashtme e recetës. *Recetaështë document i rëndësishëm juridik, prandajduhet të jetëformuluar pastër, qartëdhe me kujdes, pa shkurtime tëtepruara.*<br><br>**Seminar 14 -** Pjesët e recetës. | *fq. 189-192*<br><br>*fq.193-196* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Seminar 1 orë* |
| XV. | **Tema 29 -** Përmbajtja e recetës, modeli i një recete të përbërë *Shkurtimet më të zakonshme të recetave.*<br>**Tema 30 -** Format më kryesore të barnave. *Njohuritë themelore.*<br><br>***Seminar 15 -*** *Pjesët përbërëse të recetës.* | *fq. 196-203*<br><br>*fq.204-207* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Seminar 1 orë* |

## FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **FREKUENTIMI:** | | Kërkohet një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e seminarit janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e seminarit në orarin e përcaktuar.Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura. | | | | |
| **Mënyra e vlerësimit** | *Forma e vlerësimit* | *Koha e vlerësimit* | *Temat mësimore që do vlerësohen* | *Pikët maksimale* | *Forma e testimit të njohurive* | *Përmbajtja e testimit* |
| | Provimi I | Java 7/8 | 1-10 leksione | 30 pikë | Provim me shkrim | pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz |
| | Provimi përfundimtar | Fundi i semestrit | 11 – 30 leksione | 60 pikë | Provim me shkrim | pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Vleresim i vazhduar* | Java 14/15 | Temat e Seminarit | 10 pikë | Vlerësim me gojë | Vlerësim i njohurive në seminar |
| | **Vlerësim i vazhduar* -Do të kryhet gjatë orës së seminarit dhe do tëjetë në në vazhdimësi të të gjithë semestrit me vlerësime individuale duke u pyetur me gojë për përvetësimin e njohurive të mara në lexion. | | | | | |
| | Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë: | | | | | |
| | 40- 49 pikë | 50-59 pikë | 60-69 pikë | 70-79 pikë | 80-89 pikë | 90-100 pikë |
| | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |

| LITERATURA | |
|---|---|
| **a. Literatura bazë e detyruar** | "**Terminologjia latine**", Yllka Bilushi. 2012 (Fakulteti i Shëndetit Publik-UV) ISBN: 978-9956-00-84-6 |
| **b. Literatura e rekomanduar** | ○ "Gjuha latine", për Fakultetin e Mjekësise, Nermin Basha (Fakulteti i Mjekësisë - UT)<br>○ TEXTBOOK FOR 1ST YEAR STUDENTS OF MEDICINE COMPILED BY LA" SZLO" RE" PA" S DEBRECEN 2013 2 © László Répás, 2013. www.medi-lingua.hu ISBN 978-963-08-6589-0 http://www.ilekt.med.unideb.hu/kiadvany/4latineng.pdf<br>○ http://www.ascaniusyci.org /bodyparts-commands.pdf |

| VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS | |
|---|---|
| **Dispozita:** | Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuar. |
| **Vonesat** | Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student. |
| **Sjellja profesionale e studentit** | Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik. |
| **Integriteti akademik dhe e drejta e autorit** | Çdo test apo pune me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale.<br>Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnje burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme. |